

## GJYKATA THEMELORE E PEJËS

Numri i lëndës, P.nr. 359/12

Data, 14/06/ 2013

### NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata themelore e Pejës ne trupin gjykues te përberë nga gjyqtari i EULEX-it Jonathan Welford-Carroll si kryetar i trupit gjykues, gjyqtarja e EULEX-it Cornelia Peeck dhe gjyqtare vendore Nushe Kuka – Mekaj si anëtar te trupit gjykues dhe procesmbajtësja Christine Sengl ne lenden penale kundër:

**KP**, i biri i X dhe nënës X (vajzërisë X) i lindur me X ne fshatin X, komuna e X, me profesion avokat me gjendje te mesme ekonomike, i martuar, baba i tre fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

I akuzuar se bashku me bashke te akuzuarit, **AR** aktakuzën e zyrës se Prokurorisë speciale te Republikës se Kosovës (me tej si PSRK-se) PPS. nr. 7/2011 te datës 23.07.2012 te ushtruar ne gjykatën e qarkut te Pejës me 23.07.2012 dhe pjesërisht e konfirmuar me ane te aktvendimit te gjyqtarit te konfirmimit te EULEX-it me 20.09.2012 për veprën penale te keqpërdorimit te pozitës zyrtare dhe autoritetit te kryer ne bashkëveprim ne kundërshtim me nenin 23 dhe 339 paragrafët 1 dhe 3 te Kodit Penal te Kosovës ( KPK-së),

Pas mbajtjes se gjykimit publik më 29.01.2013 ku Ali Rexha u paraqit për PSRK-ne, Gëzim Baloku u paraqit për te pandehurin **KP** dhe palët te dëmtuara **ZM, BE, XH, XK, NA** dhe shoqata e sigurimeve te Kosovës – njësia e sigurimit te obligueshme ishin ose te pranishëm apo te ftuar qe te jene te pranishëm dhe ku i pandehuri **KP** ishte i pranishëm pas ndarjes se procedurës për **AR** me ane te aktvendimit te datës 31.01.2013 dhe na pajtim me procesverbalin e arritjes se marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë me 29.01.2013 pas këshillim – votimit te mbajtur me 14.06.2013, më 14.06.2013 ka shpallur publikisht si ne vijim:

---

**AKTGJYKIMI**

---

I pandehuri **KP** me shënimet personale të cekura si më larte është:

**FAJTOR**

Të shpërdorimit të detyrës zyrtare dhe autoritetit të kryer në bashkëveprim me **AR** në kundërshtim me nenin 3 paragrafët 2, 31 dhe 422 paragrafi 1 i KPRK ku i pandehuri **KP** ka marr pjesë në një procedurë ilegale e cila ka rezultuar në humbje të 71.257.40€ sigurimit, sigurisë së Kosovës – njësisë së obligueshme të sigurimit në Prishtinë.

\*\*\*

**PRANDAJ**, për shkak të arsyeve të lartcekura gjykata shqipton dënimet vijues:

- Për veprën penale të shpërdorimit të pozitës zyrtare të kryer në bashkëveprim i pandehuri **KP** ndëshkohet me një dënim unik të burgimit në kohëzgjatje prej një (1) viti e gjashtë (6) muaj.

Kundër të pandehurit **KP** në pajtim me nenin 3 paragrafi 1 të KPRK-se dhe nenit 56 paragrafi 2 i KPRK-se, **dënimi plotësues të ndalimit të kryerjes së funksionit në administratën publike apo shërbimeve publike** shqiptohet dënimi unik në kohëzgjatje prej tre (3) viteve pasi që të kryhet vuajtja e dënimit.

Kundër të pandehurit **KP** në pajtim me nenin 3 paragrafi 1 të KPRK-se dhe nenit 57 paragrafi 2 i KPRK-se, **dënimi plotësues të ndalimit të zhvillimit të profesionit si avokat** po ashtu shqiptohet dënimi unik në kohëzgjatje prej tre (3) viteve pasi që të kryhet vuajtja e dënimit.

Në pajtim me nenin 3 paragrafi 2 i KPRK-se dhe neneve 82 dhe 83 të KPK-se i pandehuri **KP** urdhërohet që ta paguaj shumë e të hollave që korrespondon me përfitimin material prej 71.257.40€. I pandehuri **KP** dhe bashkë akuzuari i tij **AR** janë bashkërisht dhe veç e veç përgjegjës për ri pagimin e kësaj shume.

I pandehuri **KP** duhet ti paguaj shpenzimet të procedurës penale, të vlerësuar në shumën prej 100€ së bashku me shumën paushall të vlerësuar në shumën prej 50€.

Palët e dëmtuara mund të ushtrojnë padinë për kompensim nëpërmjet gjykatave civile.

## ARSYETIMI

### 1. Sfondi procedural

#### i. Aktakuza

Më 23.07.2012 zyra e Prokurorisë speciale të Republikës së Kosovës (me tej si PSRK-se) ka ushtruar aktakuzën PP. nr. 07/2011 kundër të pandehurve **KP** dhe **AR** për veprën penale të shpërdorimit të detyrës zyrtare ose autoritetit në kundërshtim me nenin 339 paragrafët 1 dhe 3 të KPK-se, e lidhur me nenin 23 të KPK-se, dhe e lidhur me veprën e pretenduar të nxjerrjes së vendimeve të

kundërligjshme te gjykatës ne kundërshtim me nenin 346 te KPK-se,( kundër **KP**) dhe shpërdorim te pozitës zyrtare ose autoritetit, kundërshtim me nenin 339 paragrafët 1 dhe 3 te KPK-se, e lidhur me nenin 23 te KPK-se, dhe e lidhur me veprën e pretenduar te shkeljes se besimit ne kundërshtim me nenin 269 paragrafët 1 dhe 2 te KPK-se,( kundër **AR**).

Më 20.09.2012 gjyqtari i konfirmimit i gjykatës se qarkut te Pejës ka konfirmuar aktakuzën e lartcekur nëpërmjet aktvendimit KA. nr. 223/12 me 20 shtator 2012. Megjithatë gjyqtari konfirmues ka hedhur poshtë aktakuzën e ushtruar kundër te pandehurit **KP** lidhur me veprën penale te nxjerrjes se kundërligjshme te vendime te gjykatës ne kundërshtim me nenin 346 te KPK-se.

ii. **Kompetenca e gjykatës dhe përbërja e trupit gjykues**

**PREZANTIMI DHE FORMALITETET**

**1. Kompetencat gjeografike**

1.1 Në baze te aktakuzës veprat penale janë kryer brenda juridiksionit te ish gjykatës se qarkut te Pejës. Asnjë çështje nuk është ngritur nga palët ne fillim te gjykimit lidhur me juridiksionin e gjykatës.

**2. Juridiksioni dhe ligji i aplikueshëm**

2.1 Në pajtim me nenin 23 (1) te Kodit te Procedurës Penale te Kosovës ( KPPK-se), gjykatat e qarkut kane juridiksion qe te gjykojnë ne instancë te pare veprat penale te ndëshkueshme me burgim prej se paku deri ne 5 vjet apo ato veprat penale te ndëshkueshme me afat te gjate te burgimit.

2.2 Ne rastin aktual te pandehurit **KP** dhe **AR** janë akuzuar me veprat penale qe përfshijnë shpërdorim te pozitës zyrtare ne kundërshtim me nenin 339 paragrafi 3 i KPK-se, dhe vepra penale e ndëshkueshme me burgim ne kohëzgjatje prej një (1) viti deri ne 8 vjet.

2.3 Neni 3 (2) i KPRK-se parasheh se me rastin e ndryshmit te ligjit te aplikueshme për rastin aktual para vendimit përfundimtar duhet te aplikohet ligji me i favorshëm për kryerësit e veprave panele

2.4 Ne seancën e mbajtur me 07.01.2013 Gjykata Supreme e Kosovës ka nxjerr mendimin ligjor<sup>1</sup> ku ka cekur se ne te gjitha procedurat penale ku shqyrtimi kryesor ka filluar para hyrjes ne fuqi te Kodit te ri te procedurës penale, kodi i vjetër i procedurës penale do te

---

<sup>1</sup> 93/2013

aplikohet. Kjo pozite është konfirmuar ne amandamentimin e mendimit<sup>2</sup> te datës 23.01.2013.

### 3. Kompetenca e panelit

3.1 Ky rast është ndjekur nga zyra e Prokurorisë speciale te Republikës se Kosovës (me tej si PSRK-ja) ne pajtim me nenin 3.1 te Ligjit mbi juridiksion, përzgjedhje dhe caktim te lendeve te gjyqtar dhe prokuror te EULEX-it (Ligji nr. 03/L-053), gjyqtar te EULEX-it te caktuar ne procedure penale do te kenë juridiksionin dhe kompetencat mbi secilën vepër te hetuar dhe te ndjekur nga PSR-ja. Nga kjo arsye trupi gjykues i gjykatës se qarkut te Pejës ishte korrekt i përberë nga një panel i përzier nga dy gjyqtar te EULEX-it dhe një gjyqtar Kosovar ne pajtim me nenin 4.7 te ligjit mbi juridiksion. Asnjë çështje nuk është ngritur nga palët ne fillim te gjykimit lidhur me përbërjen e trupit gjykues.

#### iii. Shqyrtimi kryesor

##### 1. Në përgjithësi

Shqyrtimi kryesor është mbajtur publikisht me 29.01.2013 ne prani te Prokurorit Special **AR** te akuzuarit **KP** dhe bashke te akuzuarit e tij, **AR** dhe avokatet e tyre mbrojtës, **GB** dhe **BT**. Palët e dëmtuara ose ishin te pranishëm ose te ftuar qe te jene te pranishëm. Ne pajtim me nenin 15 te KPPK-se, përkthyesit ndërkombëtar kane përkthyer gjate procedurës se gjykimit dhe te gjitha dokumentet e gjykatës relevante për shqyrtim nga Anglishtja ne gjuhen shqipe dhe anasjelltas, sipas nevojës.

##### 2. Pranimi i fajësisë se KP

2.1 Kryetari i trupit gjykues ka mbajtur seancën paraprake me 04.12.2012. Në konkludim te seancës ai i ka udhëzuar te dy te pandehurit qe te bashkëpunojnë me avokate e tyre dhe me prokurorin special me qellim te ngushtimit te çështjes para fillimit te shqyrtimit kryesor dhe te diskutojnë mundësin e hyrjes ne marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë.

2.2 Më 25.01.2013 prokurori special ka ushtruar kërkesën për lëshimin e një urdhri duke deklaruar te pandehurin **KP** dëshmitarin bashkëpunues<sup>3</sup>. Marrëveshja e propozoi qe i pandehuri **KP** do te deklarohet i fajshëm, do te dëshmoje ne gjykatë dhe si shpagese do te pranon dënimin me burgim ne kohëzgjatje prej 1 viti. Në seancën e hapur prokurori

---

<sup>2</sup> 56/2013

<sup>3</sup> Dosja e shqyrtimit kryesor, volumi I, në lidhësen 23

special ka ushtruar një komplet të” *procesverbalit mbi arritjen e marrëveshjes se pranimit te fajësisë*” të nënshkruar nga shefi i PSRK-se, vete prokurori, i pandehuri **KP** dhe avokati i tij mbrojtës **GK**<sup>4</sup>. Në pajtim me këtë marrëveshje i pandehuri **KP** do të pranonte dënimin me burgim ne kohëzgjatje prej 1 vit e 6 muaj nëse ai deklarohet i fajshëm dhe dënimin prej 1 viti burgim nëse ai deklarohet i fajshëm ne cilësinë e dëshmitarit bashkëpunues.

**2.3** Megjithatë, ne fillim të hapjes së shqyrtimit kryesor më 29.01.2013 mbrojtësi për të pandehurin **KP** e ka njoftuar kryetarin e trupit gjykues që klienti i tij tani dëshiron të hyjë ne marrëveshje mbi mos pranimin e fajësisë<sup>5</sup>. Mbrojtësi ka deklaruar se kjo ishte për shkak të interpretimit të tij të periudhës së limituar që është aplikuar ne prokurori për veprën penale të pretenduar kundër klientit të tij. Prokurori special ka deklaruar se ai nuk i besoi mënyrës se si vepra penale është gjykuar pranë gjykatës e ka shkelur parashkrimin. Trupi gjykues është tërhequr dhe është këshilluar para se të nxjerr aktvendimin. Trupi gjykues ka vërtetuar mënyrën ku akuza pranë gjykatës është gjykuar dhe kjo nuk e ka shkelur parashkrimin.<sup>6</sup>

**2.4** Kryetari i trupit gjykues e ka pyetur të pandehurin **KP** nëse dëshiron të heq dorë nga e drejta e tij që të lexohet aktakuza që e ngarkon atë dhe ai deklaroi që po. Kryetari i trupit gjykues ka deklaruar që ai propozoi të merr shënimet personale të të pandehurit. Ne këtë moment i pandehuri **KP** ka kërkuar që përsëri të konsultoj mbrojtësin e tij. Mbrojtësi i tij me pas e ka njoftuar kryetarin që klienti i tij dëshiron të deklarohet i fajshëm ne pajtim me” *procesverbalit mbi arritjen e marrëveshjes se pranimit te fajësisë*”. Në veçanti ai dëshiroi të e bënte ne pajtim me kushtet që iu janë ofruar nëse ai dekorohet i fajshëm ne cilësinë e dëshmitarit bashkëpunues, dënimi prej 1 viti burgim do të shqiptohet.

**2.5** Mbrojtësi për bashkë të akuzuarin **AR**, avokati **BT** ka ngritur një kundërshtim. Ai ka cekur se tani ne procedurën penale është shume vone për të pandehurin **KP** që të deklarohet si dëshmitar bashkëpunues. Prokurori special bëri paraqitjet. Trupi gjykues është këshilluar dhe është pajtuar se pasi që aktakuza efektivisht është lexuar tani ishte shume vone për të pandehurin **KP** që të jete dëshmitari bashkëpunues. Atëherë kryetari i trupit gjykues e ka veçuar rastin kundër të pandehurit **KP** dhe e ka ndërprerë seancën për një date tjetër për dënimin. Kryetari i trupit gjykues rrjedhimisht ka nxjerr aktvendimin lidhur me këto kushte me datën 31.01.2013<sup>7</sup>. I pandehuri **KP** është sjell pranë gjykatës për dënimin me 14.06.2013

---

<sup>4</sup> Dosja e shqyrtimit kryesor, volumni I, në lidhësen 22

<sup>5</sup> Faqe 3 e procesverbalit të datës 29.01.2013

<sup>6</sup> Faqe 5-6 e procesverbalit të datës 29.01.2013

<sup>7</sup> Dosja e shqyrtimit kryesor, volumni I, në lidhësen 20

### 3. Gjendja faktike

3.1 Në baze të dëshmisë së lartcekur paneli ka përkufizuar si në vijim:

3.2 Që **BE** së bashku me të tjerët ka vuajtur lëndimet në aksident trafikor në Gusht 2003. Si rezultat i këtij aksidenti padia është ushtruar kundër shoqatës së sigurimit, fondi garantues për Kosovën për kompensimet. Rastit iu është dhënë numri C. nr. 916/2004. **KP** ishte gjyqtar. **KP** ka aranzhuar për **ZM** që të vepronte si avokat i autorizuar në emër të **BE** dhe **AR** autorizuar që të vepronte për fondin garantues ku ai atëherë ishte i punësuar si avokat.

3.3 Më 15.10.2004, është mbajtur seanca ku **ZM** ka propozuar që të marrin ekspertin financiar (p. sh. të sigurimeve). Askush nuk është paraqitur në seancën për të paditurin. Nënshkrimi i **ZM** në procesverbal të seancës është i vërtetë.

3.4 Në një fazë të caktuar paditësit tjerë janë shtuar në paditë, kryesisht: **XK**, **XH** dhe **NA**. **ZM** nuk ka pasur dijeni rreth këtyre paditësve tjerë.

3.5 Më 07.06.2005 është mbajtur një seance. **ZM** ka vijuar për paditësin **BE** dhe **AR** ka vijuar për të paditurin. Dy kopete të procesverbalit ekzistojnë për atë seance. Njeri nga këto pako të procesverbalit është false. Një komplet i procesverbalit është paraqitur në shqyrtimin kryesor nga **ZM** nga zyra e tij, kopja e këtij rasti. Këto procesverbale e kanë shtyrë rastin për një afat të pacaktuar për të marrë prova të mëtutjeshme. Të dy **ZM** dhe **AR** i kanë nënshkruar ato procesverbale. Të dy nënshkrimet janë të vërteta. Pakoja e dytë e procesverbalit nga dita e njëjte ka arritur të e shtyjë rastin deri më 14.06.2005. Nënshkrimi i **AR** në atë dokument po ashtu është i vërtetë. Megjithatë, nënshkrimi i **ZM** në atë dokument ishte false. Paneli konkludoi se kompleti i dytë i procesverbaleve është një krijim fiktiv i dizajnuar për lejimin e kryerjes së veprës penale dhe se **KP** dhe **AR** ishin plotësisht në dijeni rreth atij fakti dhe me dijeni kanë luajtur pjesë aktive në këtë drejtim.

3.6 Më 14.06.2005 seanca tjetër është mbajtur. Dy sete të procesverbaleve për rastin në të njëjtën ditë kanë ekzistuar. **KP** ishte gjyqtar. **AR** ka vijuar në emër të paditurit. Edhe pse procesverbali tregon se **ZM** ishte i pranishëm, provat me shkrim në këtë rast kanë vërtetuar se nënshkrimi i **ZM** në të dy sete të procesverbaleve ishin false. Gjykata konkludoi se ai nuk ishte prezent në seance. Nënshkrimi i **AR** në procesverbal që shpërblejnë shumën totale prej 72.257.40€ paditësve **BE**, **XK**, **XH** dhe **NA** nëpërmjet një marrëveshje gjyqësore është origjinale. Nënshkrimi i **AR** në procesverbal që shpërblejnë

shumen prej 13.421.30€ **BE** nëpërmjet një marrëveshje gjyqësore' mund' te jete e vërtetë/ origjinale. Ne zbardhje te të gjeturave tjera rreth pjesëmarrjes aktive dhe te ditur te **AR** ne sjellje ilegale, paneli konkludon se nuk ka dyshim se nënshkrimi po ashtu është i **AR**. Këto procesverbale janë false për shkak te mungesës se përfaqësueseve te të paditëseve, nuk mund te arrihet marrëveshje gjyqësore. **KP** e ka përdor pozitën e tij si gjyqtar qe ti krijoj këto procesverbale false. Duke i bashke nënshkruar këto procesverbale **AR** ka kontribuar substancialisht ne veprimet e **KP**.

**3.7** Si rezultat i kësaj sjelljeje **KP** dhe **AR** ne bashkëkryerje ka arritur ne përfitim prej se paku 71.257.45€ ndaj te cilëve ligjërisht nuk kishin te drejte. Te hollat janë paguar ne llogari bankare ne emrin e **ZM** me 06.09.2005<sup>8</sup>. **ZM** ia ka dhënë këtë llogari ne mënyrë efektive nen kontroll për përdorim te **KP**. Edhe pse sjellja e **ZM** ne dhënien e qasjes ne llogari **KP** ishte ne një naivitet me te mire, ai nuk është ne gjykim ne këtë rast. **KP** ka tërhequr 50.000€ nga llogaria bankare me 07.09.2005. Prova nuk vërteton se çfarë ka ndodhur me shumen e mbetur te eurove, 21.257.35 €. Nuk ka prove qe te vërtetohet se ndonjë te holle iu është paguar dikur **AR** drejtpërsëdrejti apo tërthorazi nga ku akt kriminel.

**3.8** Këto fakte kane vërtetuar se **KP** dhe **AR** janë te dy fajtor te veprës penale te shpërdorimit te detyrës zyrtare te kryer ne bashkëkryerje. Ne rastin e bashkëkryerjes nuk ka nevojë qe për secilin kryerës qe te përmbushen te gjitha elementet te veprës penale. Është e mjaftueshme kur dorasit se bashku i përmbushin këto elementet. Paneli konkludon se edhe pse **AR** nuk ishte personi zyrtar sikurse qe ceket ne neni 339, **KP** ishte. Pasi qe te dy luajtën rol aktiv dhe vepra penale vetvetiu nuk do te mund te ishte kompletuar pa aktivitetin e te dyve, te dy ndajnë përgjegjësi penale për veprat penale nen parimin e bashkëkryerjes.

Duke i konsideruar provat e prokurorisë qe trupi gjykues e pranon deklarimin e fajësisë se te pandehurit **KP**.

#### **4. Fjalimi përfundimtar**

Gjate seancës se fundit me 14.06.2013 prokurori qëndroi pranë aktakuzës dhe duke marre parasysh deklarimin e fajësisë se te pandehurit **KP** ka kërkuar qe ai te dënohet ne pajtim me Ligjin. Mbrojtësi i te pandehurit **KP**, avokati **GB** nuk ka bere paraqitjet te tjera.

---

<sup>8</sup> Prova ne dosjen I, ndarësi 13

## 5. Përcaktimi i dënimit

- 5.1 Trupi gjykues duke i konsideruar te gjitha rrethanat renduese dhe lehtësuese, konsideron se dënimi sikurse qe ceket ne dispozitivë te këtij aktgjykimi është i duhur.
- 5.2 I pandehuri **KP** ka pasur një numër te konsiderueshme te dënimeve te me hershme për veprat e ngjashme. Më 19.10.2012 ai është dënuar nga gjykata e qarkut e atëhershme e Prishtinës për lëshimin e një vendimi te kundërligjshëm gjyqësor, duke shpërdor detyrën zyrtare apo autoritetin, shpëlarja e te hollave dhe mashtrim. Ai ka pranuar dënimet prej 2, 4, 3 dhe pikërisht 4 vjet burgim. Një dënim unik prej dhjete (10) vjet burgim është shqiptuar. I pandehuri **KP** po ashtu iu është ndaluar ne ushtrim te funksionit te administrimit publik apo shërbimeve publike dhe iu është ndaluar qe te ushtroj profesionin si avokat për periudhe kohore prej tre (3) vitesh.
- 5.3 Më 24.05.2012 ai po ashtu është dënuar nga gjykata e atëhershme e qarkut te Pejës për veprën penale te shpërdorimit te detyrës zyrtare ose autoritetit. Ai ka marr dënimin prej pese (5) vjet burgim. Të pandehurit **KP** po ashtu iu është ndaluar ushtrim te funksionit te administrimit publik apo shërbimeve publike ne afat kohor prej tre (3) viteve.
- 5.4 Gjukata merr mendimin shume serioz për veprën penale lidhur me shpërdorimin e detyrës zyrtare. Këto kryesisht janë veprat penale te korrupsionit dhe korrupsioni gjyqësor është i njohur si problem i përhapur ne Kosove. Korrupsioni nder rangjet e gjyqësorisë është ne veçanti serioz pasi qe nënvlerëson besimin publik ne njërin nga shtyllat e demokracisë dhe ne sundimin e ligjit ne përgjithësi.
- 5.5 Gjukata verën se i pandehuri ka hyre ne marrëveshje te pranimit te fajësisë nga kjo duke kursyer ngarkesën e prokurorisë ne provim te rastit te saj kundër tij. Megjithatë, deklarimi i te pandehurit rreth fajësisë ka ardhur ne një faze relativisht te vonshme te procedurës.
- 5.6 Sido qe te jete faktorët e lartcekur janë lëshuar disi ne mënyrë diskutabile pasi ato kane zënë vend nga *“procesverbalit mbi arritjen e marrëveshjes se pranimit te fajësisë”* ndërmjet te pandehurit dhe PSRK-së me datën 29.01.2013. Gjukata e konsideron veten te lidhur me këtë vendim. Sidoqoftë, pasi qe gjykata e ka gjykuar te pandehurin **KP** nuk mund te deklarohej si dëshmitar bashkëpunues ai nuk ka te drejte ne dënimin prej një viti burgim sikurse qe ka rene dakord me PSRK-ne.
- 5.7 Megjithatë, ne zbardhej te dënimeve te mëhershme te të pandehurit gjykata e konsideron veten te lidhur qe te sjell një dënim unik. Sidoqoftë, nuk është e qarte nëse gjykata mund



te shqiptoj këtë dënim ne këtë faze pasi qe asnjeri nga dënimet e mëparshme të pandehurve nuk janë lëshuar ende përfundimisht. Ne këtë rast kjo gjykate është e autorizuar qe te shqiptoj dënimin final qe përfshinë dënimin prej njëmbëdhjetë (11) vjet dhe gjashtë ( 6 ) muaj burgim si te përshtatshëm. Ne këtë rast gjykata nuk ka autorizim te shqiptoj një dënim unik, konsideron se do te jete për gjykatën e apelit qe te liroj/ veproj mbi këtë funksion.

## **6. Shpenzimet**

Në pajtim me nenin 102 paragrafi 1 i lidhur me nenin 99 (1) dhe (2) nen paragrafi 6 i KPPK-se, i pandehuri duhet te paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumen prej 100€ se bashku me paushallin ne shumen prej 50€.

### **GJYKATA THEMELORE E PEJËS**

**P.nr. 359/12**

**Data 14 qershor 2013**

**Procesmbajtësi**

\_\_\_\_\_

**Christine Sengl**

**Kryetari i trupit gjykues**

\_\_\_\_\_

**Jonathan Welford-Carroll**

**Anëtare e trupit gjykues**

\_\_\_\_\_

**Cornelie Peeck**

**Anëtare e trupit gjykues**

\_\_\_\_\_

**Nushe Kuka-Mekaj**

**MJETI LIGJOR:**

Personi i autorizuar mund te ushtroj ankesën me shkrim kundër këtij aktgjykimi nëpërmjet gjykatës themelore te Pejës ne gjykatën e apelit brenda 15 ditëve nga dita kur kopja e këtij aktgjykimi te shërbehet, ne pajtim me nenin 398 paragrafi 1 te KPPK-se.